




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosova



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Istog Municipality

Nr:1	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	23.04.2025 Ora: 10:20
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Kryetari i Komunës: z. Ilir Ferati
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Ilir Ferati, Kryetari i Këshillit;</li><li>2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;</li><li>3. Shemsedin Zymberaj, Bashkësia Islame;</li><li>4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,</li><li>5. Jerej Nebojša Sekulliç, Kisha Ortodokse,</li><li>6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar;</li><li>7. Žarko Dubić, Përfaqësues i Komunitetit Serb;</li><li>8. Halil Pijuk, Komuniteti Boshnjak;</li><li>9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;</li><li>10. Selim Shabaj, Komuniteti Egjiptas;</li><li>11. Blerina Hajrizaj, Komiteti për Komunitete;</li><li>12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;</li><li>13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;</li><li>14. Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;</li><li>15. Tog. Vedat Shatri, nga FSK;</li><li>16. Blerim Gerguri, KLSP-Gurakoc;</li><li>17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;</li><li>18. Blendineta Shatri, EVSB;</li><li>19. Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;</li><li>20. Almina Eqo, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;</li><li>21. Vlera Beqiraj, KVRL;</li><li>22. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";</li><li>23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS; dhe</li><li>24. Lulzim Shoshi, Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit</li></ol>

	<p><b>Mungojnë:</b> Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë</p>
	<p><b>Pjesëmarrës tjerë:</b> Ggjyldane Ahmeti, OSBE Davic Dahl, CMSE Ssout Balkans</p>
<p style="text-align: center;"><b>Rendi i ditës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i Rendit të ditës,</li> <li>2. Siguria në zonën e përgjithshme të PK</li> <li>3. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqgues të komuniteteve etj.)</li> <li>4. Miratimi i Planit të Punës për Vitin 2026</li> <li>5. Të ndryshme</li> </ol>	

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - Përshëndet të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe gjithë të prënishmit, në veçanti antarët e ri të KKSB-së dhe ju deshiroj mirseardhje si dhe perfaqgues të KFORIT, OSBE-së, medijat si dhe musafir tjer. I informon anëtarët se Kryetari i cili ka planifikuar ta udhëheq mbledhjen është duke u kthyer nga terreni dhe me lejen e tij po fillojm mbledhjen dhe gjatë mbledhjes do na bashkohet dhe do ta kryesoj mbledhjen. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Konstatoj se nga 24 anëtar të KKSB-së, të prënishëm janë 21 anëtar dhe kemi kuorum për të vazhduar mbledhjen. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës pos këtyre që i lajmroj.

Me që nuk ka propozime tjera, miratohet rendi i ditës unanimisht.

**2. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së**

Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policisë.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - Situata në zonen e përgjegjësisë është e qet dhe stabile. Stacioni i Policisë vazhdon të punoj në bazë të Planeve Operative si dhe në bazë të Planeve dhe urdhërave nga niveli qendror dhe nga Komanda regjionale. Rrol kyq në rrejtjen e rendit dhe siguris publike, duke parandaluar vepra penale, viedhje, viedhje të rënda, droga, siguria në Shkolla dhe

Komanda regionale. Rrol kyq në rrejtjen e rendit dhe siguris publike, duke parandaluar vepra penale, viedhje, viedhje të rënda, droga, siguria në Shkolla dhe siguria ne komunikacion. Në vazhdim do ti paraqes disa statistika në krahasim me të njëjtën periudh të vitit të kaluar, gjegjësishtë krahasimi me tre mujorin e vitit 2025.

- Raste të inicuar, viti 2026 158 raste, ndersa 2025 165 raste, 4% raste më pakë krahasuar me periudhen e njëjt të vitit 2025
- Zbulueshmerua e rasteve viti 2026, 71 %, ndersa 2020, 70%
- Aksidente trafiku, viti 2026 47 raste, ndersa 2025 48 aksidente një aksident më pak, këtë tremujor,
- Aksidente me lendime viti 2026 12 raste, ndersa 2025 16 raste
- Aksidente me dëme në vitin 2026 35 raste, ndersa 2025 32 do të thot i kemi tri aksidente më shumë
- Aksidente me të lenduar viti 2026, 23, ndersa 2025 21
- Tiketa të shqiptuara, viti 2026 2235, ndersa 2025, 1003 ose 31% më shumë
- Persona të dyshuar të arrestuar, viti 2026 115, ndersa 2025 97
- Nga të arrestuarit të ndaluar, viti 2026 38 persona, ndersa 2025 40 persona
- Raste senzitive, vrasje nuk kemi pas këtë tre mujor, ndersa lendime të rënda trupore kemi një rast, vitin e kaluar një rast edhe këtë vitë një rast
- Lëndime të lehta trupore, viti 2026 21 raste, ndersa 2025 21 raste
- Viedhje të rënda, viti 2026 8 raste, ndersa 2025 10 raste
- Sa ju perket Planeve Operative, në implementim në bashkëpunim me Qendren Rajonale janë stop drogave dhe trafiku rrugor. Sa ju perket drogave besoj se keni qen të informuar edhe permes medijave se janë ndaluar persona që kan qen të involvuar me droga.
- Në muejin prill 13.04.2026 një qytetar ka humb jeten në vetaksident, gjithashtu në Fsh. Polan me traktor në vetaksident ka humbur jeten, rasti është hapur si vdekje e dyshuar dhe rastet janë duke u hetuar nga njësit rajonale.
- **Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së - falenderoj Kapitenin Gashi dhe hap debatin.**

**Halil Pijuk, Përfaqësues i Komunitetit Boshnjak-** pyetje për Komandantin e Policisë, në lidhje me një rast në Dobrush në tetor të vitit të kaluar në pronen private të familjes boshnjake janë prer drutë-mali dhe kanë qenë në shiqim-vlersim të rastit Policia dhe nga Shumarija, andaj më intereson deri ku ka arrit raste dhe a ka ndermarr Policia masa per parandalimin e rasteve të tilla me që në të kaluaren ka pas edhe rate të tjera të ngjashme dhe kjo ka të bëj me sigurin e komunitetit Boshnjak.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - sa i perket rastit konkret me që është i vitit të kaluar në këtë moment nuk mund ta jap një pergjigje konkrete, por besoj me që Policia ka hap rast i njëjti është procesuar në organet gjegjse në Prokurori, andaj për të qen i sigurt dhe transparent kerkoj nga ju që pas takimit të shkojm së bashku në stacion e gjej rastin dhe ju jap një pergjigje të detajuar.

**Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së** kerkoj që tna perkthehet pyetja e parashtruar dhe të shtrohet pyetja në gjuhen shqipe per ta marr vesh të gjithë.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së-** Drejtor për ju dhe për gjithë antarët të cilet nuk e kuptojn gjuhën ju lus që para fillimit të takimit ti kerkon ndegjueset dhe do ta keni perkthimin, për këtë arsye e angazhojm perkthyesin. Është e drejt e antarit të shprehet në gjuhen e vetë me që gjuh zyrtare në perdorim në Komunën tonë është

edhe gjuha Boshnjake, ndersa sa ju perket qytetarve që na ndjekin Ilaiv mund ta kuptojn pak a shum bazuar në pergjigjen e cila ipet per çka është shtruar pyetja por nuk kemi obligim të sigurojm perktitime.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar-** prezantohet shkaku i antarve të ri, falenderoj komandantin në prezantimin e detajuar. Kur i prezanton rastet e inicuar nese nuk paraqet ndonjë sekret më intereson ka ndonjë rast që hapet me inicim të AKI-së.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - Policia ka një bashkpunim shumë të mirë me gjitha institucionet e në veçanti atyre që nderlidhen me sigurinë dhe zbatimin e Ligjit, pra kur është në pyetje siguria jemi bashkë gjithnjë me Prokurori, Gjykatë dhe AKI si dhe institucionet tjera.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë-** pyetje per ngasësit e automjeteve të pa diciplinar a keni vendos apo a keni menduar të vendosni ndonjë kamer apo blic në pikat e rrezikshme për ti monitoruar në vazhdimsi.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - i paraqitja statistikat më heret dhe krahasuar me tremujorin e parë ka rritje prej 31%. Nuk i kamë të detajuara gjobat por kemi shum raste të konfiskimt edhe të patentshoferve per arsye të shkeljeve të rënda të rregullave të komunikacionit. Sa ju perket kamerave ju dhe gjithë qytetarët jeni në dijeni se Istogu monitorohet nga kamerat të cilat na ndihmojn shumë në parandalim dhe në zbulim të rasteve qofshin të komunikacionit apo vepra tjera penale. Janë vendos edhe në Banjë kamerat, poashtu edhe fsh. Osojanë, Lubozhd dhe kemi disa kamera edhe në Gjurakuvc.

**Lulzim Shoshi, Komuniteti i Biznesit-** vetë emri i këtij komiteti tregon që lidhet për sigurin eqytetarve, institucion per siguri primare është Policia, shfrytzoj rastin që ta falenderoj Komandantin që këtë institucion e udhëheq që një koh të gjatë. Shfrytzoj rastin ta paraqes një shqetsim të një qytetari por besoj që është shqetsim edhe i një numri më të gjerë që janë prind. Ka një koh që është problem në mes Shkolles-Policisë dhe prindve kur këta të fundit shkojn me automjete per ti marrur fëmijt nga Shkolla Bajram Curri edhe pse Policia kur gjen parregullsi e kryen punën e vetë, besoj qe gjithë së bashku mund ta gjeni një zgjidhje.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - besoj se sa i perket Policisë në psrashtrimin e pyetjes e dhe edhe pergjigjen lidhur me veprimet e Policisë. Shenjat e trafikut i ka vendos institucioni. Kur lëshohen fëmija ka një tollovi, unë në vazhdimsi i dergoj Policinë në afersi tyë Shkollave e në veçanti në Shkollën Bajram Curri shkaku i numrit të nadhë të nxënësvedhew pozitës së Shkolles. Policia e rrespekton shenjen se perveç stafit të Shkolles të tjeret e kanë të ndaluar qasjen në parkingun para Shkollës.

**Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së-** pyetja është me vënd, bashkëpunimi DKA-Polici është në sherbim të siguris për nxënës dhe staf i Shkollës. Shkolla Bajram Curri ka 1500 nxënës dhe është e pamundur që gjithë prindërit të hyjn me automjete në oborrin e Shkollës. Ky shqetsim është ngritur edhe më heret andaj DKA-Drejtori e Shkollës ka bër zgjidhje me rrugën rreth Shkollës, pra prindi hynë para fushes së sportit e merr fëmion sillet mbas Shkolle dhe kyqet në rrugë mbas Shkollës, ndersa pjesa para Shkolle është per stafin Arsimor dhe teknik të Shkollës, me këtë rast e falenderoj Policin për punen e tyre si dhe Bizneset në afersi të Shkollës qe i lejojn parkingjet e

tyre për prindër por të tillët janë të pakt për ti nxën gjitha automjetet. Për momentin nuk ka tjetër zgjidhje, ndoshta gjatë zgjerimit të rrugës UÇK-së do të kemi mundsi të hyjm pak në oborrin e Shkolles për të liruuar disa vendparkingje.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë-** Shkolles Bajram Curri ju ka bër ngarkes me nxënës. Në disa Fshatra në rrethin janë mbyllur Shkollat dhe ka raste kur prindët nuk i çojn fëmijë në Shkollën e fshatit por e siellin në Istog, andaj kjo është dominante për mbingarkesën e kësaj Shkolle.

**Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së-** Istogu nuk e ka mbyllë asnjë Shkollë amë, kanë qenë 13 dhe tani i kemi 13. Shkolla e Muzhevinave ka qen paralele e ndar e kësaj shkolle dhe me qëllim të ngritjes së cillsisë paralelet e ndara janë treguar si jo cilsose dhe mungesa e numrit të parapar të nxënësve ka bër që kjo paralele dhe dy të tjera të mbyllën. Bazuar në Ligjë, hollimi fillor është obligativ dhe prindi ka mundsi të zgjedhë cilën Shkollë dëshiron ta dergoj fëmijun dhe nuk kemi baz Ligjore ta pengojm mos ta sjell fëmijun në Istog. Pra tri paralele të ndara janë mbyll shkaku që numri i nxënësve kanë nën 50 nxënës dhe fuzionimi i këtyre nxënësve në shkollat amë ka treguar sukses shkaku i konkurencës mes nxënësve dhe stafit.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSb-së-** si komunitet disa rregulla të përgjithshme nuk na pelqejn, gjithnjë po kërkojm zgjedhjen që na konvenon, ka disa vite që e debatojm sigurinë në afersi të Shkolles Bajram Curri, andaj është bër një zgjidhje që e prezantoj Drejtori, ta quaj rreth rrotullim, ku prinderit kanë mundsi të hyjn ti marrin fëmijë dhe të dalin nga mbas objekti dhe të kyqen serish në rrugë, por të gjithë jemi për gut nuk kemi kohë të presim andaj edhe nalemi në treguar në rrugë etj, pra mentaliteti unë bëra zgjidhje tjetri le të pret pak. Kto raste ndodhin jo vetëm ngat Shkolles por keto dukuri i vrejim në gjitha sferat e jetes tek ne.

A ka dikush tjetër për diskutim. Me që nuk ka të tjerë kalojm në pikën e katert të rendit të ditës.

#### 4. Miratimi i Planit të Punës për Vitin 2026

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSb-së** -Në bashkpunim me Kryetarin dhe disa anëtarë të KKSb-së kemi hartuar një draft të Planit të Punës për vitin 2026 dhe kemi vërejt se disa nga temat që kanë qen vitet e kaluara janë hjekur nga Plani, jo pse kemi konsideru që nuk janë aktuale por që janë krijuar edhe ekipe të tjera që i trajtojn këto tema dhe anëtarët nga këto forume kanë mundsin që analizat dhe rekomandimet të prezantojn edhe në KKSb.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - ne si stacion i Policisë e kemi analizuar propozimin dhe kemi dy propozime . Marrë parasyshë zjarret që kanë ndodhur jo vetëm vitin e kaluar por edhe vitet paraprake mendojm se në Planin e Punës duhet të hyj tema: A është Istogu i përgatitur për fatkeqsi natyrore

- Reagimi ndaj permbytjeve, zjarreve dhe termeteve
- Roli i qytetarve në emergjenca dhe
- Koordinimi institucional për emergjenca

Pikë e dytë Mungesa e shenjave të trafikut në zonën e përgjegjësisë, vitin e kaluar e kemi pas një ekip të përbashkët Polici, Inspektorati i Komunes dhe trafiku rajonal ku janë identifikuar mungesa e shenjave të komunikacionit dhe besoj se në këtë pikë mund të japim kontribut edhe ne si Komitet.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKS-së** - falenderon Komandantin, dy çeshtjet e shtruar janë gjithëpërfshirë por që në piken e 7 të Planit egziston tema Mbrojtja e Pyjeve nga zjarret dhe mirëmbajtja e rrugëve malore. Jamë i mendimit se ketu mund ti shtojm si nen tema por që gjatë debatit per këtë tem i prekim edhe edhe gjitha nëntemat që jyu i potencuat. Ndersa në piken e 6 të Planit është propozuar tema Ngritja e e nivelit të sigurisë së qytetarve dhe pronave të tyre nga fatkeqsit natyrore me nëntemen Saniimi i dëmeve nga fatkeqsitë natyrore dhe fatkeqsitë tjera.

Si Drejtori i kemi të hartuar Planet e Vlersimit të rrezikut dhe Planin Operativ ku janë të paraqitura detyrat e të gjitha institucioneve dhe kjo është baza per Koordinim. Propozoj që ti analizoni edhe një her pikat 6 dhe 7 dhe të propozoni.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - ne jemi gjithë deshmitar çka ka ndodh vitin e kaluar me zjarre, A jemi si Istog te pergatitur per fatkeqsi, mendoj se kjo është pyetja që duhet ti japim pergjigje. Zjarrëfiksat kanë shumë probleme me automjete dhe ndikon në suksesin e intervenimit, ky është realiteti. A duhet të kerkojm të shtohen kapacitetet edhe me automjete të reja. Rroli i qytetarve qysh mund të kerkojm angazhim dhe të koordinojm punët mes institucioneve lidhur me këtë temë.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë-** zjarrëvenjet e qellimshme, mendoj se vijn si pasoj e piknikut në bjeshkë sepse shumë her kam has zjarre të ndezura që i kanë lan qytetarët që kanë qen per piknik-relaks në bjeshkë. Duhet të ngritet vetëdija që këta qytetar ta nalin zjarmin në perfundim të piknikut.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKS-së** - në hapsira qytetarët bazuar në Legjislacionin në fuqi nuk kanë të drejta të dhezin zjarre. Ndersa në pyetjen që e shtroj Komandanti mund të them bazuar në pervojën 25 vjeçare, Istogu nuk ka kapacitet bazuar në legjislacionin në fuqi. Por në sesilen fatkeqsi Istogu me kapacitetet që posedon dhe mundësit e bashkëpunimit me Operator Ekonomik privat. Reagimi në zjarret e korrikut dhe gushtit kanë qen të suksesëshme. Sa ju perket mungeses së kapaciteteve problemet egzistojn edhe tek baza juridike. NJPZSH-të janë staf i MPB-së, gjegjësishtë AME-së por Komunat i menaxhojn, mungesa e stafit nderlidhet edhe me Ligjin e menaxhimit të paras publike me të cilin ndahet buxheti komunal dhe percaktohet numri i pergjithëshëm i stafit bazuar në numrin e popullates rezident e i cili na kufizon punsimet në staf administrativ, kur kësaj i shtohet edhe Ligji i Arsimit dhe Shendetsis që janë prioritete atëher njësit emergjente dëmtohen. Si komun perpos kapaciteteve profesionale ne si Drejtori e kemi një listë të gjitha kompanive perfshtir edhe paisjet e tyre që në emergjenca të ndryshme mund ti perdorim, andaj në gusht edhe i kemi angazhuar, perfshtirë këtu edhe cisternat e betonit që i kemi shfrutzu per furnizim me ujë në zjarre per mos ti terhjekur cisternat e zjarrëfikësve nga intervenimi. Fatkeqsit natyrore e ne veçanti zjarret dhe verrshimet janë me msymje të shpejta që nuk ka vend në bot që mund të deklaroj që ka kapacitete per reagim. Ligjerisht pas shfrytzimit të kapaciteteve lokale Komuna i drejtohet per perkrahje institucioneve qendrore. Si komun kemi bër perpjekje edhe per perkrahje permes donacioneve dhe këtë vit jemi në rrugë të mbar per perfitim të një donacioni nga BE-ja per ngritje të kapaciteteve. Në të kaluerën kemi pas edhe ushtrime fushore me baz në komunitet por serish në munges buxhetore jo aq sa ka nevoj të kemi.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar-** temat 10 dhe 12 janë të parapara në nëntor, mendoj që shkaku i rëndsis së tyre propozoj ti shqyrtojm dy her në vitë.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** – temen 12 besoj se mund ta shqyrtoj dy herë por temen 10 nuk jam i sigurt që mund ta parshohim dy her sepse jemi të mvarur nga njesiti i veçant i Policisë-MPB-së që janë kompetent. Në raportin e fundit nga këto dy struktura është paraqitur se parashihet formimi i një forumi lokal tek i cili do delegohen kompetencat, struktur e cila është themeluar në Komunen e Kaçanikut dhe ka treguar suksese por në Komunen ton ende nuk është thjemeluar, andaj mendoj se mund ta shqyrtojm kohën e mbajtjes së debatit por për arsye të angazhimeve të këtyre strukturave besoj që nuk kemi mundsin ta organizojm dy herë.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë-** në qytetin e Istogut dhe jo vetëm, kemi disa objekte të vjetra dhe gjysëm të rrenuara që paraqesin rrezik dhe shfaqin dukuri negative. A keni ndermarr masa që ti largoni këto skandale që nuk janë të mira për qytetarë edhe për komunën tonë.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** – jemi duke e shqyrtuar Planin e Punës dhe temat per planë, por jo të shtrojm pyetja a kemi ndermarr masaper dukuri negative.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** – pajtohem me konstatimin e z. Balaj dhe mendoj se mund të jket edhe si temë, sepse në zonen tonë të pergjegjësia ka disa shtepi të djegura dhe objekte tjera që nuk i plotsojn kushtet e banimit dhe paraqesin rrezik per vetë banorët. Ka disa vite që institucionet qendrore kanë ngritë shqetsim me që në të njajtat kemi pas viktima. Pajtohem që të formohet një ekip i veçant, pjes e së cilit do të jetë edhe Policia që të dalin dhe ti evidentojn këto objekte dhe të propozojn ndermarrjen e masave. Pos objekteve mund të ketë edhe hapsira tjera si gropa etj që paraqesin rrezik për qytetar. Edhe në Banjë është një shtepi tejet e dëmtuar dhe paraqet rrezik sidomos për fëmij që shkojn për të luajtur aty.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë-** kjo pyetje ju dedikohet Kryetarit dhe nënkryetarit të Komunës sepse po vijn nga mos dhe po krijojn imazh të keq për Komunen e Istogut.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** – e patem edhe një rastë në Gjurakoc në një shtepi të pa banuar ku dikush është shku dhe ka ndez zjarr dhe ka paraqit rrezik.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar-** mendoj që këtë debat mund ta hapim kur të jetë Kryetari i Komunës prezent sepse mendoj edhe unë që si problem është plotsisht i prënueshëm.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** – po pajtohem që mund ta diskutojm si temë, por si institucione duhet të rrespektojm Ligjet. Në këtë Kshill është hap debati për sigurin e qytetarve në afersi të Ish objektit Radusha dhe është kerkuar nga Kryetari i komunes të ndermerr masa. Madje në debatin e dytë pas gjithë analizes është kerkuar largimi- rrenimin e të njëjtit me që renovimi-mirmbajtja nuk ka qen më opsion dhe Kryetari ka filluar bisedimet me institucionet perkatsë dhe ka ndermarr masa. Rastin tjetër e kemi ndermarr edhe per objektin në Gurakoc dhe sqarimet dhe kerkesat tjera nga Institucione dhe shoqria civile kanë qen të natyres tjetër që per arsye historike ky objekt mos të rrezohet por të konzervohet, gjë që ka ndodhë. Ne si drojtori i kemi në evidenc edhe disa nga këto objekte sidomos në R. Ibrahim Rugova por që të njëjtat janë prona private apo me pronsi të pa definuar ende. Pra si problem mund ta diskutojm çdo mbledhje nën piken të ndryshme, por nese percaktohem si tem duhet ti jepet një titull dhe ta debatojm një her.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimit në Komunë-** mendova se ishte duke e perfunduar mbledhjen andaj propozova. Megjithatë shumë komuna investojn edhe në prona private i izolojn dhe ua ndërrojn kulmat andaj i lejohet edhe komunës tonë.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** - programi i Qeverisë në bashkëpunim me donator për ngritjen e efikasitetit të energjis me procedura të veçanta bën izolimin e objekteve Kolektive por edhe atyre private të cilat i plotsojn kriteret e paraqitura nga Qeveria dhe donatori. Komuna nuk ka pas mundsi të aplikoj për ndertesat në Rr. Fadil Ferati me që pronsia e tyre është ende e pa definuar.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar-** pajtohem me sqarimet që i dha koordinatori lidhur me procedurat Ligjor. Por megjithatë propozoj që si të shtrojm kur është kryetari duke kryesuar mbledhjen që të analizojm gjitha mundsit ligjore për të gjetur një modalitet që të ngrisim sigurinë e qytetarve.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** - si Drejtori kemi edhe objekte tjera të identifikuara si rrezik për qytetar, shembull objekti perball Kishes kulmi i të cilit paraqet rrezik dhe shtruarja e temave a keni ndermarr apo pse skeni ndermarr masa nuk është në rregull të shtrohen si kritika pa pas baza Ligjore.

Profa Zenun paraqiti kërkesën që tema e 10-të dhe tema e 12-të të trajtohen dy herë në vit, unë e dhash një arsye sa i përket temës së 10-të dhe me që profa po pajtohet me arsyetimin pyes antarët kush është për që tema e 12-të të trajtohet dy herë në vitë dhe atë maj-nëntor.

Konstatoj që anëtarët me votë unanime u pajtuan që kjo temë të trajtohet dy herë në vitë.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** -për propozimin e komandantit e dhash një sqarim dhe pyes antarët a mund ta kemi miratimin tuaj që mbas mbledhjes së bashku me Komandantin ta harmonizojm përpilimin si temë.

**Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policisë Istog** - para se të vij në takim kam mbajtur mbledhje me stafin timë në stacion dhe kemi rënë dakord që kjo temë të shtrohet si Emergjencat dhe fatkeqësit natyrore me nënpyetjet e cekura. Ne kemi mundsi edhe të ftoj anëtar të jashtëm që ta analizojm këtë temë. Unë kërkoj që ju ta hedhni në votim dhe nese anëtarët janë të pajtimit atëherë hyn si temë nese jo mbeten temat e propozuara më heret.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** -Pyes antarët e KKSB-së kush është për ndryshimin sipas propozimit të Policisë që tema e 6-të të ndryshohet dhe të formulohet sipas kërkesës së Policisë. Me votë unanime anëtarët pajtohen që tema e 6-të formulohet sipas kërkesës së Policisë. Në vazhdim pyes kush është për miratimin e Planit të punës me këto dy ndryshime të votuara më parë. Me votë unanime antarët e KKSB-së miratuan Planin e Punës për vitin 2026.

## 5. Të ndryshme

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** - pyet antarët a ka dikush të shtroj ndonjë çështje jashtë temave të diskutuara.

**Lulzim Shoshi, Komuniteti i Biznesit-** kamë një kërkesë për Drejtorin e Arsimit. A ka mundsi ta vizitojmë së bashku Shkollën Fillore " Trepça" në Banjë dhe ta

konstatoni si është e rregulluar çështja e pushimit të gjatë në këtë Shkollë. Po e sqaroj, dera e hymjes është e mbyllur dhe nxënësit siellen dhe dalin për një derë të madhe që është për automjete e cila është e hapur dhe më pastaj shkojnë tek shitoret përball Shkollës, me këtë veprim nxënësit vetëm humbin kohë dhe gjatë ngutjes për të arritur kryejn shërbimet rreziku është edhe më i madhë. Tek dera e hymjes egziston edhe kalimi për këmbësor ndërsa atje ku fëmija dalin nuk ka kalim për këmbësor. Mendoj që me pak vullnet të stafit të Shkollës mund të bëhet zgjidhje edhe për kalimin e sigurt të nxënësve në derën kryesore.

**Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së-** jamë i njoftuar dhe tani e tri vite ajo derë është e mbyllur, shkak që ka pas aksidente dhe lendime të nxënësve. Me kërkesën e Këshillit Drejtues të Shkollës është mbyllur dera. Përpos rrezikut në komunikacion vizita e ketyre lokaleve në afërsi të shkollave po shoqërohet edhe me dukuri tjera negative që së bashku edhe me Policinë e Kosovës i kemi analizuar, andaj konform ketyre rasteve mendoj se ka qenë e qelluar mbyllja e derës.

**Lulzim Shoshi, Komuniteti i Biznesit-** Nuk do të thotë pse Këshilli e ka marrë këtë vendim që është i qelluar, i njëjti është mirë të analizohet dhe të vlersohen efektet. Me që dera e madhe për parkim të automjeteve të stafit është e hapur nxënësit po dalin neper atë derë, andaj Vendimi i Këshillit Drejtues nuk e ka arritur qëllimin dhe nuk është bërë asnjë zgjidhje me këtë Vendim. Më që nxënësit po dalin, pra ata po shkojnë 100m nga dalja në derën e madhe tek hyrja e automjeteve, serish 100 metra kthimë dhe kështu krijohet tollovi më e madhe dhe më e gjatë për gjatë rrugës pranë lokaleve dhe ekspozimi në komunikacion është më i gjatë, mendoj se me këtë nuk është bërë zgjidhje. Propozoj që të dilni në vend dhe të konstatooni, ose mbylleni derën e madhe ose hapeni të voglën përndrysh me këtë gjendje nxënësit janë ekspozuar më gjatë rrezikut.

**Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së-** nuk e thashë që kemi bërë zgjidhje, por jemi munduar të bëjmë zgjidhje, besoj se jeni në dijeni që Organi Drejtues është organi më i lartë i cili merr vendime në Shkollë. Por nëse ju vlersoni që kjo zgjidhje nuk është e duhura ju lutem që t'na paraqitni një kërkesë me shkrim dhe të njëjtën do ta shqyrtojmë.

**Lulzim Shoshi, Komuniteti i Biznesit-** Kërkesë me shkrim asnjë herë nuk do ta bëjë, unë e paraqita një kërkesë në këtë forum andaj ju si Drejtor ndermerrni masën.

**Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së-** Stafit teknik dhe kujdestari i ditës kanë obligim që të jenë prezentë dhe në oborr dhe të vlersojnë situatën.

**Lulzim Shoshi, Komuniteti i Biznesit-** tani edhe si asambleist i Komunes Istog po kërkoj nga ju që së bashku edhe me Komandantit të dalim gjatë pushimit të gjatë dhe ta vlersojmë gjendjen cili efekt është arritur me Vendimin e Organit Drejtues të Shkollës.

**Skender Hasangjakaj, Koordinator i KKS-së** -bazuar në UA KKS është organë konsultativ i Kryetarit, pra gjithnjë kërkesat e paraqitura këtu i kemi adresuar tek organi gjegjë. Me që ju jeni vetë këtu prezent dhe e ndëgjuat kërkesën nuk ka asnjë arsye të paraqes kërkesë me shkrim. Pra është një kërkesë plotsisht legjitime e Lulzimit e cila kërkon trajtim dhe kthim për gjigje.

**Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë-** Si këshill i Prindërve kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit për hapje të kiosqeve apo bifeve në Shkollë për furnizim të nxënësve. Por Udhëzimi Administrativ nuk e lejon hapjen e të njëjtëve.

**Naim Behlulaj, Drejtor i DKA-së-** Me Ligjin per Arsim dhe Rregulloren Komunale është e ndaluar hapja e kioskut por jo edhe hapja e bifeve, perveç atyre që në të kaluaren kan marrë ndonjë leje dhe është ende e vlefshme.

**Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së** - kamë pas kerkesa të shumta nga antaret në mandatin e kaluar por edhe në këtë mandat lidhur me kompenzimin per gjashtë takimet e parapara me UA. Kërkesën që e kamë bër në MPB-MAPL më është kthyer pergjigje që me Rregulloren e QRK-së janë të specifikuara mënyrat e pagesave dhe që e njëjta i ka bër të pavlefshme të gjitha rregulloret dhe UA që jënë në kundërshtim me këtë Rregullore. Megjithatë në raportin gjashtëmuor të vitit 2025 e kamë theksuar se mos pagesa e medijtjeve po paraqet problem dhe se ka pas anëtar që nuk kanë ardhë në mbledhje pa pages. Kuvendi Komunalk ka pas buxhet për pagesa por është kerkuar nxirrja e një Rregullore për mënyren dhe vleren e pageses, në nderkoh Permbaruesi i ka terhjekur mjete per pagesë të kontrates kolektive për Arsim dhe nuk ka pas mjete për pages dhe Kryetari i Kuvendit Komunal z. Enver Rugova ka kerkuar që mos tja dergoj më listat e pjesmarrjes në mbledhje sepse nuk ka mjete. Neni 8 i UA e thekson se pagesen duhet ta bëj Komuna perkatsë e cila themelon KKSB-në. Drejtoria per Financa ka marr obligim në vitin 2025 që ta nxjerr Rregulloren Komunale. Këtë shqetsim tuajin do ta adresoj serish tek Kryetari dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar-** Në mbledhjen e ardhëshme duhet tna ipet një pergjigje a do të paguhen anëtarët e Komitetit dhe si do të kompenzohen dhe më pastaj është e drejt individuale të vendos secili a do të jet pjes e këtij Komiteti pa pages nëse vendoset të mospaguhet.

**Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSB-së** - Per kete arsye që ta kemi pergjigjen në mbledhjen e radhes pyeta kush është per që kjo tem të adresohet tek Kryetari dhe Drejtori.

Me që nuk ka diskutime lidhur me këtë pik kalojm në piken e gjashtë të rëndit të ditës.

**Mbledhja perfundoj:**

11.45